



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

## Raport Konsultativ

Shqyrtimi i Shtatë i Tarifave të Energjisë Elektrike

**SHTE7 (2013-2017)**

Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it

### DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është përgatitur nga ZRRE për të marrë komente eventuale nga palët e interes. Dokumenti nuk paraqet vendim të ZRRE-së.

**19 tetor 2012**

## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>Komente të përgjithshme</b> .....	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>Vlerësimi i Shpenzimeve Kapitale të Operatorit të Transmisionit të KOSTT-it</b> .....	<b>2</b>
3.1	Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Transmisionit.....	2
3.2	Modelimet e investimeve kapitale që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën.....	2
3.3	Shpenzimet Operative të Operatorit të Transmisionit.....	2
<b>4</b>	<b>Vlerësimet për Operatorin e Sistemit të KOSTT-it</b> .....	<b>3</b>
4.1	Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Sistemit.....	3
4.2	Shpenzimet Operative të Operatorit të Sistemit.....	3
<b>5</b>	<b>Vlerësimi i Kostove të Operatorit të Tregut të KOSTT-it</b> .....	<b>3</b>
5.1	Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Tregut.....	3
5.2	Shpenzimet Operative të Operatorit të Tregut .....	3
<b>6</b>	<b>Hapat e mëtutjeshëm</b> .....	<b>3</b>
<b>1</b>	<b>Hyrje</b> .....	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>Metodologjia</b> .....	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>Të dhënat e dorëzuara</b> .....	<b>4</b>
<b>4</b>	<b>Dorëzimi i shpenzimeve kapitale të KOSTT 2013-2017</b> .....	<b>5</b>
4.1	Projektet kapitale .....	5
4.2	Kostot e njërive .....	5
<b>5</b>	<b>Gjetjet</b> .....	<b>6</b>

### 1 Hyrje

Më 8 qershor 2012 ZRRE kishte filluar Shqyrtimin e Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE7) i cili për herë të parë do të mundësojë përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për një periudhë shumë-vjeçare. Sipas Ligjit, këto të Hyra Maksimale të Lejuara duhen të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kostot e kapitalit që kanë të bëjnë me aktivitet e rregulluara. Për të përcaktuar shumën e të Hyrave të nevojshme, ZRRE duhet të vlerësojë parashikimet e të licencuarve për kostot e nevojshme dhe të jetë e bindur se propozimet e të licencuarve janë të arsyeshme. Baza ligjore i obligon të licencuarvit të ofrojnë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ZRRE për qëllim të vlerësimit të kësaj analize. Për këtë arsye, në qershor ZRRE është konsultuar me palët e interes lidhur me formularët që do të përdoren për të mbledhur të dhënat e këtij shqyrtimi tarifor. Pas konsultimit, të licencuarit kanë pasur 8 javë për të plotësuar formularët. Të licencuarit kanë dorëzuar formularët e tyre më 3 shtator. Të licencuarit nuk kanë sjellur formular të kompletuar. Rrjedhimisht ZRRE është takuar me të licencuarit për të qartësuar të dhënat e dorëzuara. ZRRE ka vlerësuar aplikacionet e KOSTT-it me ndihmën e një kompanie ndërkombëtare inzhinjerike. Vlerësimet fillestare të ZRRE-së janë dhënë më poshtë. Informata më të detajuara janë dhënë në Shtojcën A të këtij dokumenti.

### 2 Komente të përgjithshme

Të dhënat e kërkuara nga ZRRE për qëllim të shqyrtimit shumë-vjeçar kanë qenë të detajuara lidhur me shpenzimet e viteve të kaluara dhe ato që propozohen për të ardhmen. ZRRE e kupton që mungesa e përvojës së kompanive lidhur me kërkesat e ZRRE-së mund të ketë vështirësuar dorëzimin e të dhënave të kompletuara dhe të justifikuara. Pavarësisht takimeve të numërta në mes të ZRRE-së dhe kompanisë gjatë kësaj periudhe, disa pyetje të konsiderueshme mbesin ende të paqarta. Këto kryesisht kanë të bëjnë me:

- Mungesën e arsyeshmërisë së nevojshme për kostot e propozuara;
- Mospërputhjet me burimet e tjera të informatave, posaçërisht me Planin Zhvillimor të Rrjetit ; dhe
- Ofrimin e informative shtesë dhe përmbledhjeve të nevojshme për të mbështetur parashikimet e kostove

Në mungesë të të dhënave mbështetëse, ZRRE mund të vendosë që disa prej elementeve të kostove janë të pajustificueshme dhe t'i përjashtojë nga llogaritjet e Të Hyrave Maksimale të Lejuara. Është e rëndësishme që i licencuari të marrë parasysh këtë dhe të qartësojë e të justifikojë të gjitha informatat e kërkuara nga ZRRE apo konsulentët e saj.

### **3 Vlerësimi i Shpenzimeve Kapitale të Operatorit të Transmisionit të KOSTT-it**

Gjetjet kryesore të shqyrtimit fillestar të ZRRE-së për Shpenzimet e OT-së së KOSTT-it janë si më poshtë.

#### **3.1 Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Transmisionit**

Propozimet e KOSTT-it për shpenzimet kapitale të operatorit të transmisionit mund të përmbledhen si në vijim:

- Të dhënat e dorëzuara fillimisht kanë paraparë investime totale prej 118.5 milionë euro prej të cilave 36.4 milionë janë të financuara nga grantet
- Prej këtyre 84 milionë euro (71% e shpenzimeve totale kapitale) duket të jenë justifikuar në Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit (NDP)
- Pastaj KOSTT ka ridorëzuar një parashikim tjetër me investime kapitale prej 123.1 milionë euro prej të cilave 37.9 milionë euro janë grante
- Prej totalit të shumës vetëm 77.3 milionë euro janë përfshirë në Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit dhe, prej këtyre, vetëm 21 milionë euro janë të financuara nga grantet
- Për momentin vetëm 56 milionë euro mund të konsiderohen si shpenzime neto të KOSTT-it

Gjatë kësaj periudhe consultative ka pasur ndryshime të konsiderueshme në parashikimin e shpenzimeve kapitale të KOSTT-it. Këto ndryshime nuk janë sqaruar në Planin Zhvillimor të Rrjetit dhe duhen justifikuar nga KOSTT-i.

#### **3.2 Modelimet e investimeve kapitale që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën**

Shpenzimet kapitale të KOSTT-it duken të jenë dukshëm më të ulëta se niveli i sugjeruar nga modeli i investimeve kapitale që kanë të bëjnë me ngarkesën dhe të atyre që nuk kanë të bëjnë me ngarkesën. Parashikimi 5-vjeçar i KOSTT-it poashtu nuk i përfshinë nevojat për zëvendësimin e rrjetit.

#### **3.3 Shpenzimet Operative të Operatorit të Transmisionit**

Ka pasur vonesa të konsiderueshme në marrjen e informatava nga KOSTT-i sa i përket arsyeshmërisë së shpenzimeve operative të propozuara për operimin e transmisionit të cilat kanë kufizuar mundësinë e ZRRE-së për të analizuar të dhënat e dorëzuara. Vlerësimet fillestare sygjerojnë kostot e 2012 janë të mëdha krahasuar me nivelet historike të kostove dhe, pa sqarimet dhe justifikimet e nevojshme për këto kosto mund të jetë e vështirë që ZRRE të lejojë kërkesën e propozuar.

## **4 Vlerësimet për Operatorin e Sistemit të KOSTT-it**

### **4.1 Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Sistemit**

KOSTT-i ka përfshirë një vlerë prej 10 milionë eurosh të shpenzimeve kapitale në parashikimin për shpenzimet 2013-2017. KOSTT-i nuk ka ofruar informata lidhur me natyrën e këtyre kostove dhe nuk i ka justifikuar ato. Në mungesë të këtyre informatave është e vështirë që këto kosto të lejohen nga ZRRE si investime kapitale në kuadër të Shqyrtimit shumë-vjeçar.

### **4.2 Shpenzimet Operative të Operatorit të Sistemit**

Shpenzimet Operative të Operatorit të Sistemit përbëhen kryesisht prej shpenzimeve për paga. Kërkesa e KOSTT-it është që këto kosto të rriten për 5% për vit përgjatë periudhës së parashikuar. KOSTT-i thekson se kjo korrespondon me rritjen e stafit për mirëmbajtjen e njehsorëve si dhe operimin me paisje të reja SCADA. Këto rritje në staf normalisht në vendet tjera nuk ndodhin, përkundrazi me implementimin e pajisjeve SCADA vjen deri tek ulja e numrit të stafit, posaçërisht numrit të të punësuarve në nënstacione të cilët kryesisht reduktohen me implementimin e SCADAs. KOSTT duhet të ofrojë informata shtesë për të justifikuar rritjen e kostove të personelit mbi nivelin e lejuar në 2012.

## **5 Vlerësimi i Kostove të Operatorit të Tregut të KOSTT-it**

### **5.1 Shpenzimet Kapitale të Operatorit të Tregut**

KOSTT-i nuk kanë propozuar të bëjnë investime kapitale për Operatorin e Tregut për periudhën e shqyrtimit shumë-vjeçar.

### **5.2 Shpenzimet Operative të Operatorit të Tregut**

Kostot operative të Operatorit të Tregut të KOSTT-it janë kryesisht kosto të personelit. KOSTT-i parasheh që këto kosto të rriten për 2.5% për vit për periudhën e parashikuar. KOSTT-i nuk ka ofruar justifikim lidhur me rritjen e propozuar dhe në mungesë të saj do të supozohet se niveli i tanishëm i pagave do të vazhdojë të aplikohet përgjatë periudhës së parashikuar.

## **6 Hapat e mëtejshëm**

KOSTT-i mund të komentojë në vlerësimet fillestare të ZRRE-së mbi aplikacionet e tyre dhe të ofrojë plotësime dhe justifikime për të përkrahur aplikacionin e tyre. Nëse nuk ofrohen justifikimet e nevojshme, ZRRE duhet të marrë qëndrimin e vet për nivelin e duhur të disa kostove.

Përgjigjet e KOSTT-it duhet të dorëzohen para orarit të punës më 9 nëntor 2012.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it

Pas marrjes së përgjigjeve të KOSTT-it në këtë document, ZRRE do të përgatisë Vlerësimet e Përkohshme të MAR-it për divizionet e licencuara që pritet t'i dërgohet kompanisë në fund të dhjetorit 2012. Në të njëjtën kohë, ZRRE do t'i dërgojë KOSTT-it modelin e të hyrave që është zhvilluar për të përkrahur llogaritjen e MAR-it në pajtim me Rregullat e Çmimeve.

## Shtojcë

### Dorëzimi i shpenzimeve kapitale të KOSTT OST

#### 1 Hyrje

Kjo Shtojcë paraqet vlerësimin e ZRRE të informatave të KOSTT të ofruara në pyetësin për tarifa shumëvjeçare të dorëzuara më 31 gusht 2012, takimet pasuese sqaruese dhe dokumentacionit shtesë të ofruar nga KOSTT.

#### 2 Metodologjia

Për vlerësimin e shpenzimeve kapitale, ZRRE ka:

- Rishikuar dorëzimin e informatave kundrejt Planit Zhvillimor të Rrjetit (PZHRR) të ofruara nga KOSTT për periudhën përkatëse për të vlerësuar nëse informatat janë nxjerrë sipas procesit të planifikimit të investimeve të bartësit të licencës dhe nëse janë në pajtim me fushat e identifikuar nga i licencuari si fusha prioritare. ZRRE i ka identifikuar projektet të cilat ishin të përfshira në PZHRR dhe në dorëzimin e shpenzimeve kapitale, si dhe ato që ishin të përfshira ose në dorëzimin e shpenzimeve kapitale ose në PZHRR por jo në të dyja.
- Rishikuar parashikimin e shpenzimeve kundrejt shpenzimeve historike. KOSTT nuk ka siguruar shpenzimet historike kapitale të kërkuara nga ZRRE. Megjithatë, ZRRE ka nxjerrë një shifër nga informatat për jetëgjatësinë e aseteve.
- Rishikuar kostot e njësisë të përdorura nga KOSTT në zhvillimin e parashikimit të shpenzimeve kapitale.
- Përdorur gjetjet e analizave të mësipërme për të përcaktuar nëse është i nevojshëm ndonjë rregullim në shpenzimet e parashikuara kapitale.

#### 3 Të dhënat e dorëzuara

Dorëzimi i shpenzimeve kapitale të KOSTT përfshin parashikimin e shpenzimeve kapitale sipas projektet, siç është kërkuar. Gjithashtu, ata kanë paraqitur një profil të hollësishëm të vjetërsisë së aseteve, jetëgjatësinë e pritur të tyre si dhe kostot e njësisë.

PZHRR dhe dorëzimi i shpenzimeve kapitale nuk përputhen dhe nuk është paraqitur asnjë arsyeshmëri për një numër projektsh në dorëzimet e shpenzimeve kapitale. Ky është përfundim

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it

befasues, meqë pritej që dorëzimi i shpenzimeve kapitale nga ana e KOSTT-it të jetë bërë duke ndjekur për së afërmi PZHRR-në aktuale, që identifikon dhe arsyeton projektet për zhvillim të transmisionit.

KOSTT nuk ka paraqitur profil historik të shpenzimeve. Megjithatë, ka shfrytëzuar informatat e profilit të vjetërsisë së aseteve dhe të kostos së njësive për të nxjerrë modelin e shpenzimeve historike kapitale në çmimet aktuale.

## 4 Dorëzimi i shpenzimeve kapitale të KOSTT 2013-2017

### 4.1 Projektet kapitale

Dorëzimi fillestar i KOSTT për shpenzime kapitale kapte shumën prej gjithsej 118.5 milionë euro me grante në vlerë prej 36.4 milionë. Projektet në dorëzimin e parë përfshinin interkoneksionin e ri me linjën 400 kV të transmisionit me Shqipërinë, linjat e reja 110 kV të transmisionit, përforcimin dhe rehabilitimin e linjave 110 kV të transmisionit, si dhe nënstacionet e reja dhe të përmirësuara 220/110 kV, 110/35 kV dhe 110/10 (20) kV.

Kur janë krahasuar projektet kapitale me Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit (PZHRR) 2012-2021 është gjetur se vetëm 84 milionë euro (71% të gjithsej shpenzimeve kapitale) kishin arsyeshmëri në PZHRR.

KOSTT është kërkuar të shpjegojë mospërputhjen dhe ka dorëzuar sërish shpenzimet kapitale. Dorëzimi i sërishëm i shpenzimeve kapitale është gjithsej 123.1 milionë euro, nga të cilat 37.9 milionë euro të financuara nga grantet. Edhe më tej paraqitet një mospërputhje e konsiderueshme me zhvillimet e përshkuara në PZHRR.

Duke shfrytëzuar ridorëzimin si bazë për vlerësimin e shpenzimeve kapitale, Tabela 1 paraqet projektet që kanë arsyeshmëri brenda PZHRR-së apo arsyeshmëri të veçantë të paraqitur nga KOSTT. Gjithsej shpenzimet kapitale për këto projekte janë 77.3 milionë euro (63% e shpenzimeve kapitale totale). Veç kësaj, 21 milionë euro nga ky total i shpenzimeve kapitale financohet nga grantet. Projektet e mbetura në parashikimin e ridorëzuar nuk kanë arsyeshmëri të veçantë në PZHRR. Shpenzimet kapitale të lidhura me këto projekte korrespondojnë me 45.8 milionë euro (123.1 milionë euro minus 77.3 milionë). Përveç nëse KOSTT mund vërteton këto projekte, ato nuk mund të merren parasysh në lejimin e përgjithshëm të shpenzimeve kapitale gjatë MYT(SHTSH).

ZRRE ka kërkuar arsyeshmëri shtesë apo shpjegim lidhur me atë se pse projektet në PZHRR nuk janë përfshirë në dorëzimin e shpenzimeve kapitale mirëpo, deri më sot, nuk është ofruar një gjë e tillë.

### 4.2 Kostot e njësive

Kostot e njësive janë paraqitur në ridorëzim.

## Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it

ZRRE ka rishikuar kostot e njësive të paraqitura nga KOSTT. Kostot e njësive janë përgjithësisht më të ulëta se që do të duhej pritur, posaçërisht në rastin e pajisjeve ndërprerëse (*switchgear*) ku kostot janë 20-25% më të ulëta sesa në tregjet e krahasueshme

## 5 Gjetjet

Vetëm 77.3 milionë euro të shpenzimeve kapitale në dorëzime janë të përfshira në Planin Zhvillimor të Rrjetit të Transmisionit, të cilat si pasojë janë të arsyetuara sipas nevojave për zhvillim të sistemit.

Nga kjo, 21 milionë euro financohen nga grantet, që nënkupton që vetëm 56 milionë euro të shpenzimeve neto të KOSTT-it aktualisht mund të përfshihen në kostot MYT.

KOSTT duhet të sqarojë pse ka mospërputhje ndërmjet projekteve të përfshira në dorëzim dhe atyre në PZHRR, si dhe në veçanti të shpjegojë pse janë propozuar projekte të reja dhe si mund të arsyetohen ato, si dhe pse projektet tjera të listuara në PZHRR nuk janë përfshirë në dorëzimin për MYT.

Një vlerësim fillestar i kostove të njësive i paraqitur nga KOSTT tregon se disa prej tyre janë përgjithësisht të arsyeshme sipas standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, disa kosto të njësive duket të jenë shumë të ulëta, posaçërisht për ndërprerësit.

Mbetet të shqyrtohet, duke i shikuar informatat e mëtejme apo arsyetimin e mundshëm të KOSTT-it si përgjigje ndaj këtij konsultimi, nëse rregullimet e kostove të njësive janë adekuate. Gjithashtu, KOSTT duhet të ofrojë më shumë hollësi të kostove të njësive (me klasifikim) të shfrytëzuara gjatë përpilimit të kostove të tyre në projekt. Në mungesë të këtyre informatave shtesë, ZRRE mund të supozojë kosto më të ulëta të njësive sesa ato që KOSTT mund t'i arsyetojë.